

**Mbi**  
**Auditimin e Brendshëm**  
**Ushtruar në Njesine Administrative Rrethina**

Njesia e Auditimit Brendshem – Bashkia Shkoder bazuar ne ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te Auditimit te Brendshem ne sektorin publik”, zhvilloi nje mison auditimi te plote ne Njesine Administrative Rrethina per periudhen 01.01.2015 – 30.12.2015, ku nga auditimi rezultoi:

Permbledhje ekzekutive

Njësia e Auditimit të Brendshëm- Bashkia Shkodër, auditoi ish- komunën Rrethina, (me reformën e re territoriale ) Njësia Administrative Rrethina.

Njësia Administrative Rrethina– Bashkia Shkodër, në periudhën Janar-Gusht 2015, është audituar nga njesia e Auditit Prefektures dhe nga ana jone nuk u bë auditim duke e marrë ne konsideratë.

Grupi i auditimit i Bashkisë Shkoder i ngarkuar per kryerjen e angazhimit të auditimit i ka kushtuar vemendje te veçante transferimit te veprimtarise dhe asetëve në Bashkinë Shkodër menaxhimit te pasurise. Gjate auditimit jane konstatuar mangesi rregullore të brendshme ku të percaktohen qartë ndarja e detyrave, caktimi i pergjegjesisë, pavarësia, vlerat etike dhe kompetencat e punonjësve, vendimmarrja, ne funksionimin e kontrollit te brendshem, kryesisht ne vendosjen e objektivave, ne pershkrimin e proceseve te punes ne kontrollin e aktivitetieve, ne monitorimin dhe informimin si dhe ne hartimin dhe ndjekjen e regjistrit te rrishtit. Ka mangesi ne administrimin e vlerave materiale, ne dokumentimin e aktivitetëve, ne administrimin e te ardhurave ne mbulimin e Njësise Administrative me sherbime te percaktuara ne ligjin e veteqeverisjes vendore.

## **GJETJET DHE REKOMANDIMET**

**1.Gjetje** : Jane konstatuar mangesi ne percaktimin e strukures specifike per Njesine Administrative Rrethina, ka mangësi në perpilimin dhe miratimin e rregullores së brendëshme, nuk ka të percaktuar funksionimin e kontrollit të brendshëm, nuk ka percaktuar objektivat, nuk është perpiluar regjistër rrishtit, nuk është bërë ndarje e detyrave bazuar ne burimet njerzore ne dispozicion.

### **Rekomandim**

**a.** Te kerkohet me shkrim pranë organeve drejtuese te Bashkisë Shkoder per percaktimin e struktures organike dhe kompetencave te Administratorit dhe administratën për emërimin e Kryetarëve të Fshatrave sipas percaktimeve të neneve 65, 66, 70 te ligjit 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”

**b.** Perpilimin e rregullores se brendëshme të Njësise Administrative Rrethina ne pershtatje me ligjin nr. 10296 date 08.07. 2010“Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe (sipas modelit të rastit studimor nr. 03 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit), perfshire detajimin ne menyre analitike të të gjitha aktivitetëve qe kryen çdo punonjës, pershkrimin e vendit të punes detajimin e

sistemit të kontrollit sipas aktiviteteve, dhe më pas miratimin e rregullore nga Kryetarja e Bashkisë.

**c.** Përcaktimin e objektivave të institucionit, vlerësimin e mundësisë së ndodhjes së ngjarjeve, *si dhe perpilimin e regjistrit të rriskut*, sipas modelit të rastit studimor nr. 04 të manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**d.** Për fushat që nuk mund të mbulohen me specialiste të Njësise Administrative të kërkohej që funksionet të kryhen nga specialistet e Bashkisë qendër sipas Drejtorive në qendër të Bashkisë.

**2.Gjetje.** Drejtimi ka mangësi në ngritjen e sistemit të monitorimit dhe raportimit, nuk është kryer informimi sipas hirerarkisë, Drejtorite e Bashkisë Qendër nuk kryejnë monitorim të shërbimeve dhe aktiviteteve.

**Rekomandim:** Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të informimit dhe monitorimit, si dhe kryerjen e dokumentimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efikasitetit të institucionit.

**3.Gjetje :** Ka mangësi në përcaktimin strukturor të funksionimit të administratës të njësise Administrative Rrethina, nuk janë lidhur kontrata me punëmarresin, duke vepruar në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 9761 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të punonjësve, nuk janë përcaktuar dhe ndjekur fushat me rrisht të lartë:

**Rekomandim .**Për të gjithë punonjësit që nuk janë pjesë e shërbimit civil marrëdhëniet e punësimit të rregullohen me kontratë pune sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë

**4.Gjetje.** Planifikimi i buxhetit nuk është bërë bazuar rregullorë të vecante të hartimit të buxhetit, buxheti nuk është perpiluar bazuar në nevojat në arritjen e objektivave.

**Rekomandim**

**a.** Të kërkohej me shkrim pranë Drejtorisë Buxhetit për pajisjen me një rregullorë për perpilimin e projekt buxhetit të njësise.

**b.** Planifikimi i buxhetit për Njësine Administrative Rrethina të bëhet bazuar në burimet dhe nevojat e njësise Administrative e argumentuar me tregues ekonomik-financiare.

**5.Gjetje.** Planifikimi i të ardhurave nuk është bërë bazuar në burimet e njësise Administrative, arketimi i të ardhurave ka qënë në nivelin të ulët , nuk është bërë evidentimi, regjistrimi dhe përpjekja për arketim i detyrimeve të tatimpaguesve, nuk është perpiluar regjistri i tatimpaguesve, nuk ka patur bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë Ardhurave Bashkia Shkoder dhe Njësise Administrative për vjeljen me forcë të detyrimeve të taksapaguesve.

**Rekomandim**

**a.** Administrata e njësise Administrative Rrethina të fillojë menjëherë punën në bashkëpunim me Kryetaret e fshatrave për të ndërtuar regjistrin e tatimpaguesve, i ndarë sipas aktiviteteve të biznesit.

**b.** Administrata e njesisë Administrative Rrethina te fillojë menjehere punen ne bashkepunim me Kryetaret e fshatrave per te ndertuar regjistrin e tatimpaguesve per familjaret , duke evidentuar siperfaqen e tokes ne perdorim dhe në pronesi, siperfaqen e kullotave , pyjeve, fidanishte, frutore, sipas ndarjes se paketes fiskale të miratuar.

**c.**Për siperfaqet e tokave, pyjeve e kullotave qe nuk jane në pronësi të familjeve por që përdoren prej tyre të lidhet kontrate qiraje për përdorimin e tyre.

**d.** Administrata e Njesisë Administrative Rrethina , bazuar ne dokumentet qe disponohen te filloje evidentimin e detyrimeve te pa arketuara nga tatimpaguesit per vitet e mepashme dhe duke perdorur masat shtrenguese parashikuara nga ligji per te bere te mundur arketimin e tyre.

**6.Gjetje:** Janë kryer pagesa per shperblimin e Kryetareve të Fshatrave, pa qënë të zgjedhur apo të emëruar , duke vepruar në kundërshtim me nenin 70 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” , duke shkaktuar dem ekonomik per vlerë për vlerë 160.000 lek,

**Rekomandim:** Te nderpritet pagesa e kryetareve te fshatrave dhe te kerkohet me shkrim per emrimin e tyre.

**7.Gjetje:** Ka mangesi në ndjekjen e debitoreve, dhe kreditoreve, ne inventarizimin e pasurise , në perpilimin e rregullores aseteve, ndertimin e planit per mirmbajtjen e aseteve, në administrimin e vlerave materiale .

Rekomandim

**a.** Per ndjekjen e debitoreve ne bashkepunim me Drejtorine e te Ardhurave te filloje puna per vjeljen me force te detyrimeve sipas kërkesave te ligjit per procedurat Tatimore.

**b.** Te behet kerkese me shkrim pranë nëpunësit autorizues dhe zbatues per analizen dhe nxjerrjen e pergjegjesive te vendimeve gjyqësore te pa-ekzekutuara.

**c.**Per investimet e kryera per te cilat nuk ka perfunduar procedura dokumentare ligjore si edhe detyrimet per garancine e punimeve, te kerkohet me shkrim prane Kryetares se Bashkise per ngritjen e nje grupi pune te perbere nga specialiste te Drejtorise se Investimeve dhe te Drejtroise se Kontrollit te Territorit, per te bere te mundur verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes se ketyre investimeve, dhe nese nga ky komision konstatohen dëme per vlerat e garancise se punimeve te mos realizohet kryerja e pagesave deri ne riparimin e dëmeve.

**d.** Te filloje puna per perpilim e rregullores aseteve sipas kerkesave te ligjit te Menaxhimit Buxhetor dhe Udhezimit per Menaxhimin e Aseteve ne Sektorin Publik.

**8.Gjetje:** Nuk ka gjetur zbatim pika 13 e *Udhezimit nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njesisë së sektorit publik”*

**9.Gjetje:** Nuk është bere planifikimi i punes per kryerjen e sherbimeve publike, si dhe ka mangesi ne caktimin e normativave te karburantit si dhe ne perdorimin e karburantit.

**Rekomandim:** Planifikimin dhe miratimin e kryerjes sherbimeve publike, si dhe kryerjen e kronometrimit per caktimin e normativave shpenzimit karburantit si dhe pasisjen me flete udhetime, ku detyrimisht te percaktohet itinerari , levizjes, vendi i kryerjes sherbimit, volumet e punes kryera dhe ne fund te nenshkruhen nga personi qe ka kryer sherbimin, personi qe ka kontrolluar sherbimin dhe ne fund miratohet nga administratori.

**Njesia Auditimit Brendshem  
Bashkia SHKODER**